



Ndërmarrjes Publike – Korporata Energjetike e Kosovës – KEK Sh.A.

Adresë: Sheshi “Nënë Tereza” nr.36, 10000 Prishtinë
Përfaqësuar nga: z. Bekir Gërguri, Kryeshef Ekzekutiv (ud)
Në tekstin në vijim “KEK”

dhe

Ndërmarrjes Publike – Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. - INFRAKOS

Adresë: Sheshi i Lirisë nr.36, 12000 Fushë Kosovë
Përfaqësuar nga: z. Naser Krasniqi, Kryeshef Ekzekutiv
Në tekstin në vijim “INFRAKOS”

dhe

Ndërmarrjes Publike – Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A.

Adresë: Rr. Salih Puçolli pn. 12000 Fushë Kosovë
Përfaqësuar nga: z. Agron Statovci, u.d. Kryeshef Ekzekutiv
Në tekstin në vijim “TRAINKOS”

Apo bashkërisht te referuara si “Palët”

Palët bashkërisht pajtohen që të lidhin kete Marrëveshje te Bashkëpunimit:

Neni 1 QËLLIMI I MARRËVESHJES

- 1.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshje te Bashkëpunimit (ne tekstin e mëtejme: *Marrëveshja*) është ofrimi i bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet ndërmarrjeve publike për shfrytëzimin e shërbimeve që palët ofrojnë. Shfrytëzimi i shërbimeve të ndërsjella do të realizohet në mënyrë efikase, efektive dhe me qëllim të përmirësimit të performancës financiare.
- 1.2 Palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën në ofrimin e shërbimeve që ndihmojnë në zhvillimin e infrastrukturës dhe optimizimin te resurseve dhe shërbimeve, konform fushëveprimit te tyre:
 - a) KEK do të ofrojë shërbime dhe mbështetje nga sektori përkatës për prodhimin e qymyrit për furnizim me qymyr, si dhe sektorët tjerë për ndihme me pajisje për transport dhe për pune
 - b) INFRAKOS do të ofrojë shërbime dhe mbështetje lidhur me infrastrukturën hekurudhore.
 - c) TRAINKOS do të ofrojë shërbime dhe mbështetje në fushën e transportit hekurudhor dhe logjistikës.

Neni 2

KUSHTET E BASHKËPUNIMIT

- 2.1 Palët do të krijojnë grupe pune për të menaxhuar dhe koordinuar aktivitetet e përbashkëta.
- 2.2 Çdo palë është përgjegjëse për sigurimin e resurseve dhe kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të saj sipas marrëveshjes.
- 2.3 Palët do të ndajnë informacionin e nevojshëm dhe të rëndësishëm për realizimin e Marrëveshjes, duke siguruar që të gjithë informacionet janë të sakta dhe të përditësuara.

Neni 3

OBLIGIMET E PALEVE

3.1 Obligimet e KEK:

- a) **Furnizimi me Thëngjill:** KEK do të ofrojë furnizimin me thëngjill për nevojat e Infrakos dhe Trainkos, kundrejt një kompensimi sipas tarifave zyrtare të KEK në fuqi
- b) **Trajnime Profesionale:** KEK do të ofrojë trajnime profesionale në Qendrën së Trajnimeve në fushat e mëposhtme:
 - (i) Teknologji mekanike (14 module)
 - (ii) Teknologjia e saldimit (18 module)
 - (iii) Teknologji elektrike (18 module)
 - (iv) Teknologji Informative (10 module)
 - (v) Siguria në punë (2 module)
 - (vi) Operimi me makina të rënda (7 module)
- c) **Shërbime makinerike:** KEK do të ofrojë shërbime makinerike në Fabrikën Pajimeve Xehetare & KosovoMont
 - (i) Rregullimi i motorëve të ndryshëm
 - (ii) Përpunimi i metaleve (gdhendja)
- d) Kompensimi për shërbimet si më lart (për pikat a deri c) do të kryhet sipas tarifave/#mimoreve zyrtare.

3.2 Obligimet e INFRAKOS:

- a) **Shërbimi i Mirëmbajtjes së Binareve:** INFRAKOS do të bëjë shërbimet e mirëmbajtjes së binareve industriale, duke përfshirë furnizimin me binarë, traversa dhe aksesore përcjellës të nevojshëm për mirëmbajtjen e binarëve dhe funksionimin e tyre, me një kompensim sipas tarifave zyrtare të Infrakos.
- b) **Asistencë dhe Trajnime Profesionale:** INFRAKOS do të ofrojë asistencë profesionale nga fusha hekurudhore dhe trajnime nga kjo fushë dhe certifikimi i stafit të KEK-ut, sipas kërkesës, si dhe të shkëmbejë përvoja nga fushat administrative, burimet njerëzore dhe sigurisë në punë.

3.3 Obligimet e TRAINKOS:

- a) **Shërbimi i Transportit:** TRAINKOS do të ofrojë shërbime të transportit hekurudhor të brendshëm dhe ndërkombëtar, për transportin e peshave të rënda dhe të punonjësve me trenat të rregullt, kundrejt një kompensimi sipas tarifave zyrtare të Trainkos.
- b) **Asistencë dhe Trajnime Profesionale:** TRAINKOS do të ofrojë asistencë dhe trajnime profesionale nga fusha e transportit hekurudhor, dhe certifikimit të stafit të KEK-ut, sipas kërkesës dhe do të shkëmbejë përvoja nga burimet njerëzore dhe siguria në punë, përfshirë edhe shkëmbimin e eksperteve.

Neni 4 **TRAJTIMI I KËRKESAVE**

- 4.1 Palët pajtohen që do të trajtojnë me prioritet kërkesat e ndërsjella për shfrytëzim të infrastrukturës tokësore, pajisjeve dhe mjeteve motorike specifike në rast të nevojave emergjente të palëve ose për nevoja të implementimit të projekteve që janë në interes publik dhe të lidhura me fushëveprimin e kësaj marrëveshjeje.
- 4.2 Kërkesat duhet të jene ne forme zyrtare, dhe trajtimi i tyre do të jete brenda një afati të arsyeshëm, por jo me vone se 14 (katërbëdhjetë) dite kalendarike.
- 4.3 Trajtimi i kërkesave do të behet nga personat mbikëqyrës të kësaj marrëveshjeje të cilët nga secila palë nënshkruese do të kete nga një zyrtar. Një forme zyrtare e dorëzimit të kërkesës, bashkë me elementet përcjellëse, dhe zyrtarin përgjegjës, do të përgatitet nga Palët.

Neni 5 **KOHËZGJATJA DHE SHKËPUTJA E MARRËVESHJES**

- 5.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë prej tre (3) vite me mundësi vazhdimi.
- 5.2 Secila palë ka të drejtë të shkëputet nga Marrëveshja duke dërguar njoftimin paraprak me shkrim të Palët tjera ne afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë.
- 5.3 Paraprakisht, në rast të shkeljes së kushteve të Marrëveshjes nga ndonjëra palë, palët do të bisedojnë dhe do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje të përbashkët për zgjidhjen miqësore të kontestit.

Neni 6 **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 6.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet ne mënyrë miqësore përmes negociatave të ndërsjella ndërmjet palëve.
- 6.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje miqësore e mosmarrëveshjes, do të njoftohet përfaqësuesi i aksionarit, ne këtë rast, Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP)/ME, dhe pas kësaj, Palët mund të drejtohen në gjykatën kompetente në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 7 **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE**

- 7.1 **Detyrimet Financiare:** Palët pajtohen që detyrimet financiare për shërbimet e ofruara që janë objekt i kësaj Marrëveshjeje nga fusha e mirëmbajtjes së binareve dhe furnizimit me thëngjill, dhe tjera t'i përmbushin me kohë dhe pa vonesa. Lidhur me shërbimet që lidhen me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, Palët zotohen se nuk do të angazhojnë apo blejnë shërbime nga palë te treta apo kontraktore të jashtëm për shërbimet e përfshira ne kete marrëveshjeje, ne pajtim me ligjet ne fuqi. Detyrimet financiare në mes të palëve do të përmbushen në përputhje me tarifat zyrtare të palëve të cilat janë në fuqi në kohen kur kryhet shërbimi i kërkuar.
- 7.2 **Shërbime të tjera:** Palët pajtohen që shërbimet tjera nga fusha e trajnimeve, asistencës profesionale dhe shkëmbimit të përvojave, që nuk janë objekt i kësaj Marrëveshjeje, t'i ofrojnë pa kompensime.

- 7.3 **Pajtimi i Palëve:** Marrëveshja e nënshkruar nënkupton se palët janë pajtuar ndërmjet veti dhe obligimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje do t'i përmbushin.
- 7.4 **Ndryshimi i Marrëveshjes:** Çdo ndryshim në këtë Marrëveshje do të bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të regjistrohet në formën e një akti të veçantë (si Aneks apo Amendament).
- 7.5 **Hyrja në fuqi e Marrëveshjes:** Marrëveshja hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga të gjitha Palët. Kjo marrëveshje përbëhet nga katër faqe dhe është e hartuar në tri kopje, një për secilën palë.

Nënshkruar në Prishtinë, më datë 04/10/2024

Për KEK



z. Bekir Gërguri, Kryeshef Ekzekutiv (ud)



Për INFRAKOS



z. Naser Krasniqi, Kryeshef Ekzekutiv



Për TRAINKOS



z. Agron Statovci, Kryeshef Ekzekutiv (ud)

